



FILLOJNE SHTRENJTIMET



Me arsyetimin se është ngritur TVSH dhe akciza në duhan, cigareshitësit që nga e hëna janë marrë vesh të ngritin çmimet e cigareve për 20 centë. Importuesit nuk kanë prekur çmimet. Që nga dita e parë e janarit, pritet valë e re e shtrenjtimeve. ■ f10



Lëshimet e Kuvendit

OSBE i rekomandon Kuvendit të Kosovës koordinim më të mirë me Qeverinë për të mos vonuar miratimin e projektligjeve. Të shikojë mundësinë e rregullimit të kohës për pyetje parlamentare në një mënyrë më të efektshme. Të konsiderojë krijimin e një mekanizmi për të siguruar kuorum në mbledhjet e komisioneve dhe t'i publikojë rezultatet e votimit elektronik. ■ f7

Express

E enjte

25 dhjetor, 2008

www.gazetaexpress.com

N° 1376, Viti III, Çmimi: 0.20 € • E përditshme e pavarur kosovare

Kërkojnë dorëheqjen e Alushit

Mospërbushja e marrëveshjes prej 44 eurosh, arrestimet spektakulare të mjekëve, deklarata e Ministrit se anëtarët e FSSHK janë të ndikuar politikisht, si dhe shumë arsye të tjera, kanë bërë që Federata Sindikale e Shëndetësisë së Kosovës të kërkojë dorëheqjen e përvokueshme të Ministrit Alush Gashi. Zyrtarët e MSH nuk pajtohen me këtë kërkesë. ■ f8

Hajde flasim për komunistët **KOMENT**

Ligji Çek për Dosjet u ndalon gjithë ish-drejtuësve komunistë, në poste të larta, bartjen e posteve publike në Çekinë post-komuniste! Si do të dukej Kosova me një Ligj të tillë? Shkruan: Ilir Mirena ■ f2

Ramush 2

Ndryshimi ka ardhur në AAK, por duhet ta shihni. Ka pasur gabime në Qeveri, sa nuk isha unë. Luftën kundër korrupsionit e kemi korrptuar të gjithë. Në të ardhmen, LDK do të vendosë vetë a e ka më mirë me PDK'në a me AAK'në. Qeveria e Thaçit nuk ka plan. Me Qeverinë time, pas zgjedhjeve, të gjithë do të befasonen. Dhe, sërish, disa fjalë për SHIK'un. Ramush Haradinaj flet për Express. ■ f4-5-6




FOTO: VISAR KRJEZIU

VIKENDET JANË TË LIRA!

1 CENT

PËR THIRRJE DHE SMS
BRENDA RRETHIT



PËR PAKOT
Allo? & Tung!



HYNI
n'ExpressOnline

www.gazetaexpress.com

duk gjini

Shërbimi "Mënyrë Shërbimi", 21, Tel/Fax: 036 222004, 222005, 222006

Arté

REDAKTOR: Shkelzen Maliqi
E-MAIL: shkelzen.maliqi@gazetaexpress.com
TEL: 038 76 76 76 FAX: 038 76 76 78



Arta Dobroschi ambasadore e UNDP

Sukseset e fundit që ka pasur aktorja Arta Dobroschi, kanë bërë që të marr ftesën të jetë ambasadore e UNDP në Kosovë. UNDP në Kosovë, ka përmbyllur aktivitetet me ngjarjen e fundit për këtë vit, me emërimin e Dobroschit, kampione e radhës për Objektivat e

Zhvillimit të Mijvjeçarit duke avokuar mbi rëndësinë e arritjes së këtyre objektivave në Kosovë deri në vitin 2015. Dobroschi, ka pranuar këtë ftesë. Ajo emërohet "Kampione e OZHM-ve" dhe do t'i bashkëngjitet Lorik Canës, futbollistit tonë të mirënjohur, dhe

Zoran Ristic, regjisor teatri, në luftë kundër varfërisë, arritjes së shkollimit fillor, përmirësimit të shëndetit të fëmijëve dhe nënave, fuqizimin e grave, luftën kundër sëmundjeve ngjitëse, mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e partneriteteve globale.

MARINAJ FITON 'ARB NORIN'

Poeti, përkthyesi dhe eseisti shqiptar, Gjekë Marinaj, i cili jeton në SHBA, është laureuar me çmimin "Pjetër Arbnori", që e jep Qendra Ndërkombëtare e Kulturës në Tiranë. Ky çmim vitin e kaluar i ishte dhenë poetit amerikan Frederick Turner.

Alfred Beka

alfred.beka@gazetaexpress.com

PRISHTINË, 24 DHJETOR — Qendra Ndërkombëtare e Kulturës në Tiranë ka shpallur këto ditë fitues të çmimit "Pjetër Arbnori", në letërsi për vitin 2008, poetin, përkthyesin e eseistin Gjekë Marinaj, pedagog i letërsisë bashkohore në Universitetin e Richlandit, Dallas, SHBA.

Çmimi "Pjetër Arbnori" mban emrin e disidentit, shkrimtarit dhe humanistit të shquar shqiptar dhe jepet nga Qendra Ndërkombëtare e Kulturës një herë në vit. Ai vlerëson një shkrimtar për arritjet e tij në letërsi.

Çmimi është i hapur si për autorët shqiptarë ashtu edhe për shkrimtarët e huaj të cilët kanë botuar në gjuhën shqipe.

Çmimi "Pjetër Arbnori" i jepet një shkrimtari, poeti apo dramaturgu për arritjet e tij në letërsi. Ai është një çmim global dhe vlerëson krijimtarinë e vazhdueshme të një krijuesi, si dhe kontributin e tij të vazhdueshëm në letërsi në nivel botëror.

Për herë të parë ky çmim në vitin 2007 iu dha poetit amerikan Frederick Turner, kandidat për çmimin "Nobel" në letërsi, një nga zërat më të fuqishëm të poezisë botërore, i cili është sjellë në shqip nga "Marinaj Publishing."

Ndërsa për vitin 2008 Qendra Ndërkombëtare e Kulturës i jep Çmimin "Pjetër Arbnori", poetit dhe përkthyesit Gjekë Marinaj.

I lindur në Brrut të Malësisë së Madhe në vitin 1965, Gjekë Ma-



rinaj shkollën fillore dhe 8-vjeçare e mbaroi në fshatin e lindjes, ndërsa maturën e përfundoi në Shkollën Teknologjike të Shkodrës. Nga gjendja e vështirë, sidomos pas botimit të disa poezive ku goditej direkt dogmatizmi dhe donkishotizmi i një regjimi despotik, që po jepte shpirt, për t'i shpëtuar përndjekjeve dhe dhunës pa arsye të regjimit komunist, torturave që të çonin në çmendi, ai u detyrua të largohej nga vendlindja, në rrethana tepër ekstreme.

Pasi kalon në SHBA, Marinaj i kushtohet studimeve.

Kështu, në vitin 1994, ai përfundoi studimet në Institutin Mjekësor ASPT në Arlington. Katër vjet më vonë u diplomua në Shkollën e Përgjithshme të Kolegjit Brookhaven në Dallas. Shkollën e Lartë të Arteve dhe Humanitetit e përfundoi në vitin 2002, në Universitetin e Dallasit, në Teksas. Që nga janari i vitit 2003, ai vazhdon studimet për Master, në Degën e Letërsisë Botërore në

UTD. Dy herë, në vitin 1997 dhe 1998, Organizata Akademike e Kolegjit Brookhaven e nderoi Gjekë Marinajn me titullin "Student i vitit", për shkak të rezultateve të larta në mësim. Gjatë jetës studentore, ai mori edhe disa çmime letrare. Vlen të përmendet çmimi "Pena e artë" (nëntor '98) dhe veçanërisht, trofeu "International Poet of Merit Award", me të cilin Marinaj u nderua nga "International Society of Poets", me 17 nëntor 2002.

Shkrime me karakter akademiko-letrar i janë botuar në disa gazeta dhe revista letrare amerikane. Emri i tij është përfshirë në 4 antologji poetike amerikane: "A Moment in Time" (1995), "A Muse to Follow" (1996), "Best Poems of the '90's" (1999) dhe "Echoes From the Silence" (2003). Po kështu, në vitin 2003, dy poezitë e tij u përfshinë në antologjinë "Un alfabet al poeziei albaneze" në Rumani, përkthyer dhe botuar në rumanisht nga shkrimtari Ardian Ky-

cyku. Në vitin 1995, Gjekë Marinaj doli me përmbledhjen e parë poetike, me titull: "Mos më ik larg". Pesë vjet më vonë, pikërisht në vitin 2000, boton edhe librin e dytë me poezi "Infini". Libri i tretë i tij ka një natyrë tjetër. Marinaj boton "Ana tjetër e pasqyrës", një libër me intervista të zgjedhura me personalitete të rëndësishme të letërsisë, politikës dhe sportit, nga bota dhe Shqipëria. Libri doli nga shtypi në tetor 2003.

Gjekë Marinaj kryen dy punë; njëra në Baylor University Medical Center, Departamenti i Patologjisë, dhe tjetra në Richland College, ku jep mësim në letërsinë botërore. Shtëpia botuese "Marinaj Publishing" është pasioni i tij, në ndihmë të shkrimtarëve dhe poetëve shqiptarë. Nuk duhet haruar edhe kontributi i tij i pakursyer në themelimin Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë, ku Marinaj drejton edhe revistën "Pena", organ i kësaj shoqate.

Kanë thënë për poetin Gjekë Marinaj

“Gjekë Marinaj dallohet ndër poetët më të mirë shqiptarë të kohës. Kjo do të thotë se ai zë vend midis poetëve më të mirë evropianë. Në universin e tij poetik ka një harmoni të mrekullueshme midis shpirtësisë ballkanase, më e vjetra e kontinentit, dhe asaj planetare. Siç ndodh shpesh me poetët e vërtet, kjo harmoni kalon nga jeta te vepra poetike dhe anasjelltas. Kështu për shembull, kur lexojmë poezinë e tij për kalimin e Akeronit, lumit të skëterrës, atë që ndan jetën nga vdekja, s'ka si të mos na kujtohet episodi prekës, ku ai, djaloshi i ri, u arratis dramatikisht nga Shqipëria totalitare më 1990, duke kapërcyer me "not" një lumë, që shërbente si kufi”.

Ismail Kadare

“Një botë ku poezia shpesh tingëllon si një mplakje, e rraskapitur dhe si një luftëtare gati e dorëzuar në mbrojtje të pikave të fundit të sensibilitetit letrar, Gjekë Marinaj shpërthen në skenë me tërë shkëlqimin e rinisë, me energjinë erotike dhe maturinë e një poeti të pjekur. Ai na tregon një mënyrë që ta shohim botën - përtej realizmit magjik, përtej mendjemadhësisë metafizike, madje dhe përtej surealizmit ngjyrë plotë të Evropës Lindore - që tregon se akoma jemi në agun shpresëplotë të civilizimit human.”

Frederick Turner, kandidat për Çmimin Nobel në letërsi

“Kur miku im, Prof. Jerry Kuye, më tha se kishte zbuluar një poet të veçantë nga të gjithë poetët që ai kishte lexuar më parë, mendova se poezitë (që mi la për t'u hedhur një sy) do të ishin të shkruara me numra apo simbole abstrakte e jo me shkronja. Vetëm pasi i lexova ato, të cilat mbanin për autor poetin Gjekë Marinaj, e kuptova se ku ishte fjala. Nëse Marinaj vazhdon të shkruajë kështu, ka gjasa se një ditë jo të largët, e gjithë bota letrare do e kuptojë domethënien e fjalëve vlerësuese të Prof. Kuye-s për Gjekën.”

Wole Soyinka, fitues i çmimit Nobel në letërsi, 1986